



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.411/2021
Datë: 29 dhjetor 2021

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.4, 1.12, 1.17, nenit 30 paragrafi 3, 6 dhe 8 të Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 15 dhe 35 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat, Rregullores (09/2016) mbi Procedurat e Zgjedhjes, Emërimit, Vlerësimit, Pezullimit dhe Shkarkimit të Kryetarëve të Gjykatave dhe Gjyqtarëve Mbikëqyrës (të ndryshuar dhe plotësuar), në takimin 274-të, të mbajtur më datë 29 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M


- I. Z. Shefqet Baleci, emërohet gjyqtar mbikëqyrës në Gjykatën Themelore Prishtinë dega në Gllogovc.
- II. Mandati i z. Baleci, si gjyqtar mbikëqyrës është pesë (5) vjeçar dhe do të filloj nga data 01 janar 2022.
- III. Vendimi hyn në fuqi më datën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me vendimin KGJK.nr.238/2021, të datës 2 shtator 2021, ka shpallur konkurs për gjyqtar mbikëqyrës në Gjykatën Themelore Prishtinë dega Gllogovc. Komisioni Vlerësues për Intervistim, Vlerësim dhe Rekomandimin e kandidatëve për pozitën gjyqtar mbikëqyrës në Gjykatën Themelore Prishtinë dega Gllogovc, i ka rekomanduar Këshillit Gjyqësor të Kosovës një (1) kandidat.

KGJK, në takimin e mbajtur më datë 29 dhjetor 2021, pas shqyrtimit të rekomandimit të komisionit, me votim të fshehtë dhe me shumicë të votave, përzgjedhi dhe emëroi z. Baleci, gjyqtar mbikëqyrës në Gjykatën Themelore Prishtinë dega Gllogovc. Andaj, nga se u tha si më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Z. Shefqet Baleci, gjyqtar mbikëqyrës në Gjykatën Themelore Prishtinë dega Gllogovc;
- Znj. Albina Shabani - Rama, kryetare e Gjykatës Themelore Prishtinë;
- Departamentit të Administratës së Përgjithshme të SKGJK-së;
- Sekretariatit të KGJK-së si dhe Arkivit.